



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

V E N D I M

Nr. 49, Datë 10/04/2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 16, datë 21.02.2019, e Znj. E.K., ku pretendohet diskriminim i djalit të saj K.H.¹, për shkak të “aftësisë së kufizuar”, nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Drejtorisë Arsimore Rajonale Korçë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, si dhe mbështetur në dokumentacionin bashkëlidhur, rezulton se 16 vjeçari K.H. vuan nga autizmi dhe është cilësuar invalid i grupit I-rë³. Aktualisht K.H. mëson në klasën e gjashtë pranë Shkollës Speciale Korçë dhe ankuesja thekson faktin se djali i saj ka nevojë emergjente për asistencën e një mësuesi ndihmës, fakt që është konstatuar dhe rekomanduar edhe nga Komisioni Multidisciplinar i DAR Korçë. Znj. E.K. e bën me dije Komisionerin se në fillim të vitit shkollor 2018-2019, ajo e ka regjistruar djalin e saj pranë Shkollës 9-vjeçare “Naum Veqilharxhi”, Korçë, por në mungesë të një mësuesi ndihmës, K.H. e kishte të pamundur të ndiqte procesin mësimor pranë kësaj shkolle. Ajo shprehet se ka

¹ K.H. vuan nga autizmi.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

³ Referuar Vërtetimit nr.1851, të lëshuar nga DRSHSSH Korçë.

bërë përpjekje të vazhdueshme pranë drejtorisë së shkollës 9-vjeçare “Naum Veqilharxhi”, Korçë për të siguruar një mësues ndihmës për djalin e saj, në mënyrë që ai të ndiqte mësimin pranë kësaj shkolle, por kjo nuk u arrit. E kushtëzuar nga rrethanat e mësipërme, ankuesja e regjistroi djalin e saj pranë Shkollës Speciale Korçë.

Në datën 19.11.2019, Znj. E.K. i është drejtuar me kërkesë me shkrim, DAR Korçë, ku kërkohet vlerësimi i nevojave arsimore për mësues ndihmës së djalin e saj, K.H.. Në vijim të kësaj kërkesë, Komisioni Multidisiplinar pranë DAR Korçë ka zhvilluar mbledhje në datën 07.12.2018, nga e cila kanë dalë në përfundim se nxënësit K.H. i nevojiten 4 orë në ditë asistencë me mësues ndihmës, si dhe ndjekjen e PEI, ku duhen të përshkruhen në mënyrë të hollësishme objektivat mësimore dhe ato të aftësisimit për jetën. Për sa më sipër, Komisioni Multidisiplinar i është drejtuar Drejtorit të DAR Korçë me shkresën nr. 702, datë 19.12.2018, ku e informon lidhur me përfundimet e vlerësimit psiko-social për nxënësin K.H.. Pavarësisht kësaj, nxënësit K.H. ende nuk i është siguruar një mësues ndihmës, i cili duhet ta ndihmojë dhe asistojë atë gjatë procesit mësimor, pranë Shkollës Speciale Korçë.

Ankuesja E.K. thekson faktin se në datën 06.02.2019, i është drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe për dijeni DAR Korçë e Shkollës Speciale Korçë, me një ankesë me shkrim, nëpërmjet së cilës informon mbi situatën konkrete, si dhe kërkon zgjidhjen e kësaj çështjeje, duke i caktuar një mësues ndihmës djalit të saj K.H.. Në adresë të Znj. E.K. nuk është dërguar asnjë përgjigje zyrtare nga asnjë nga institucionet e sipërpërmendura.

I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 16, datë 21.02.2019, së Znj. E.K., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga nenin 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

Mbështetur në nenin 33, pika 7⁴, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë

⁴ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

dhe Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Rajonale Korçë, me shkresën nr. 289/1, datë 25.02.2019⁵, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:

- Informacion, nëse ankuesja E.K. ka depozituar ankesë me shkrim pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, DAR Korçë dhe Shkollës Speciale Korçë. Nëse po, MASR dhe institucionet e sipërpërmendura të dërgojnë pranë KMD-së, kopje të ankesës së protokolluar, si dhe përgjigjeve zyrtare të dërguara në adresë të ankueses;
 - Kopje e plotë e dosjes së K. H., që administrohet nga Komisioni Multidisiplinar pranë DAR Korçë;
 - Informacion mbi arsyet e moszbatimit të rekomandimit të Komisionit Multidisiplinar të DAR Korçë, për caktimin e një mësuesi ndihmës për nxënësin K.H..
 - Informacion nëse është hartuar dhe miratuar PEI për nxënësin K.H. nga Komisioni përkatës pranë Shkollës Speciale Korçë, si dhe të dërgohet një kopje e PEI-t dhe vlerësimeve të kryera nga ky Komision për këtë nxënë;
 - Çdo informacion tjetër që ka lidhje me çështjen e parashtruar nga ankuesja E.K..
1. Në përgjigje të shkresës nr. 289/1, datë 25.02.2019, së Komisionerit, Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë dërgoi shkresën nr. 161, datë 05.03.2019, nëpërmjet së cilës e informon KMD-në se çështja e ngritur nga ankuesja E.K. është zgjidhur, pasi nxënësit K.H. i është caktuar mësues ndihmës.
 2. Në përgjigje të shkresës nr. 289/1, datë 25.02.2019, të Komisionerit, Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit dërgoi shkresën nr. 2284/1, datë 18.03.2019, nëpërmjet së cilës e bën sërish me dije KMD-në, mbi të njëjtin fakt, sikurse DAR Korçë, duke theksuar faktin se mësuesja ndihmëse për nxënësin K.H., është emëruar në datën 25.02.2019.
 3. Në vijim, ankuesja E.K. depozitoi pranë Komisionerit, kërkesë me shkrim, nëpërmjet së cilës tërhiqte ankesën e saj ndaj subjekteve të sipërpërmendura, duke e konsideruar çështjen e zgjidhur, falë ndërhyrjes së Komisionerit, pasi djalit të saj i ishte caktuar mësues ndihmës.

⁵Shkresa nr. 289/1, datë 25.02.2019, e KMD-së iu dërgua për dijeni Shkollës Speciale Korçë, Komisionit Multidisiplinar pranë DAR Korçë dhe ankueses E.K..

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 17 dhe nenin 94, pika 1, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Përfundimin e proçedurës së shqyrtimit administrativ të ankesës nr. 16, datë 21.02.2019, së Znj. E.K., pasi kjo e fundit ka depozituar pranë KMD-së, kërkesë për tërheqje të ankesës.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Shkak – aftesi e kufizuar
Fusha- te mira dhe dherbime